




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Data e dorëzimit të raportit		viti	
30 - 11		2018	
Emri i autorit		vendi	
SKPMGHCK 7244/2018		111	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 330 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Prishtinës, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Prishtinës.
2. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Prishtinës, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës dhe
- Arkivit të Këshillit.


Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit





DERBI I A E KASAPËRE DERBI I A KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Përshkrimi / Description Pratje / Attachment Inchaj / Attachment		30.11.2018		8	vit / year
Organizuesi / Organizator OrgUnit	Nr. Prot. or Prot. Prot.No	Shprehja Prilog Appendix	Kopje / Quantity		
SKPMSHCK	7244/2018		1/15		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL
NË
KOMUNËN E PRISHTINËS
PËR VITIN
2017

Prishtinë, 2018

Faqe 1 nga 15

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë”, Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
<https://kpmshe.rks-gov.net/>

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
FUNKSIONI MBIKËQYRËS I KËSHILLIT	3
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES	3
FUSHAT E MBIKËQYRJES	3
RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJSLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL KOMUNËN E PRISHTINËS	5
I. OGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE	9
II. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT	10
III. PROCEDURAT DISIPLINORE	11
IV. PROCEDURAT E ANKESAVE	12
V. PROCEDURAT E VLERËSIMIT	12
VI. PROCEDURAT E PUSHIMEVE	13
VII. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT	13
VIII. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA	13
IX. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS	14
X. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK	14
XI. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS	14
XII. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL	14
XIII. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET	15
XIV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT	15
XV. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJSLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL	15

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar “Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton “Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësi për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementimit të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në

kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL KOMUNËN E PRISHTINËS

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Komunën e Prishtinës, për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Komuna e Prishtinës përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Komunën e Prishtinës me datë 11.10.2018, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Akt emërimi për nëpunësin në vendin e punës “Inspektor i Shërbimeve Publike”;
- Vendimi i datës 14.07.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës;
- Vendimi i datës 14.07.2017 për pagesë me rastin e pensionimit;
- Vendimi i datës 05.10.2017 për ndërprerje të marrëdhënies së punës me dorëheqje;
- Vendimi i datës 28.07.2017 mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje;
- Vendimi i datës 28.07.2017 mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje;
- Vendimi i datës 10.11.2017 mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje;
- Vendimi i datës 19.09.2017 për caktim të ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 04.09.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 16.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 05.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 05.09.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 29.09.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 19.06.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 16.11.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 25.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 12.05.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 14.04.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 05.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 14.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 01.11.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 06.07.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 16.03.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 16.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;

- Vendimi i datës 27.02.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 05.07.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 10.07.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 01.03.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 16.11.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 10.07.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 07.01.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 05.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 16.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 06.09.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 16.11.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 25.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 04.05.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi i datës 10.01.2018 për pezullimin e dakorduar;
- Akt emërimi i nëpunësit në vendin e punës “Inspektor i Ndërtimit”;
- Akt emërimi i nëpunësit në vendin e punës “Zyrtar për gjendje civile 2”
- Vendimi për transfer i datës 31.10.2017;
- Marrëveshja e datës 10.10.2017 për transfer;
- Vendimi i datës 16.10.2017 për transfer;
- Vendimi i datës 16.08.2017 për pushim mjekësor pa pagesë;
- Vendimi i datës 19.09.2017 për pushim pa pagesë;
- Vendimi i datës 20.09.2017 për pushim pa pagesë;
- Vendimi i datës 11.12.2017 për pushim të lehonisë;
- Vendimi i datës 07.11.2017 për pushim të lehonisë;
- Vendimi i datës 26.07.2017 për pushim të lehonisë;
- Vendimi i datës 27.06.2016 për pushim të lehonisë;
- Vendimi i datës 06.06.2017 për pushim të lehonisë;
- Vendimi i datës 18.05.2017 për pushim të lehonisë;
- Vendimi i datës 14.02.2017 për pushim të lehonisë;
- Vendimi i datës 23.03.2017 për pushim të lehonisë;

- Procesi i rekrutimit për vendin e punës “Inspektor i shërbimeve publike – tre (3) ekzekutues”;
- Procesi i rekrutimit për vendin e punës “Inspektor i Ndërtimit” një (1) ekzekutues;
- Procesi i rekrutimit për vendin e punës “Zyrtarë i Lartë Ligjor”;
- Vendimi i datës 10.03.2016 për formimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimi i datës 26.01.2016 për formimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Vendimi i datës 09.08.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Vendimi i datës 14.07.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Vendimi i datës 28.08.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Vendimi i datës 23.06.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Ankesa e datës 24.05.2017 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Ankesa e datës 13.07.2017 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 07.03.2017;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.08.2017;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 03.03.2017;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 30.08.2017;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 03.03.2017;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 24.07.2017;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.09.2017;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 12.06.2017;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 03.03.2017;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 23.04.2017;
- Vendimi i datës 30.05.2017 i Komisionit Disiplinor me shkresat e bashkangjitura për inicim të procedurës;
- Vendimi i datës 19.04.2017 i Komisionit Disiplinor me shkresat e bashkangjitura për inicim të procedurës;
- Vendimi i datës 22.12.2017 i Komisionit Disiplinor me shkresat e bashkangjitura për inicim të procedurës;

- Vendimi i datës 22.12.2017 i Komisionit Disiplinor me shkresat e bashkangjitura për inicim të procedurës;
- Vendimi i datës 22.02.2017 i Komisionit Disiplinor me shkresat e bashkangjitura për inicim të procedurës;
- Vendimi i datës 09.03.2017 i Komisionit Disiplinor me shkresat e bashkangjitura për inicim të procedurës;
- Vendimi i datës 08.12.2017 i Komisionit Disiplinor me shkresat e bashkangjitura për inicim të procedurës;
- Vendimi i datës 08.11.2017 i Komisionit Disiplinor me shkresat e bashkangjitura për inicim të procedurës.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

I. OGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Komunën e Prishtinës më datë 11.10.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës e cila zbatohet që nga vitit 2016, klasifikimi dhe sistematizimi i vendeve të punës është bërë në pajtim me rregulloren e brendshme. Akt emërimet e nëpunësve civile janë në pajtim me organizimin e brendshëm, Komuna e Prishtinës, numrin e nëpunësve civil të miratuar me buxhet e ka 540 dhe se 22 pozita janë të lira.

Ushtuesit e detyrës: Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2017 ka pasur njëzet e dy (22) pozita me Ushtues të Detyrës dhe se Kolegji ka konstatuar se për pozitën me ushtues të detyrës për vendin e punës “Udhëheqës i Sektorit të Rendit Komunal”, “Udhëheqës i Sektorit për Kadastër” në Drejtorinë e Kadasrit, “Drejtor i Arkivit Komunal”, “Drejtoresh e Qendrës Kulturore të Fëmijëve”, “Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin të Mbeturinave”, “Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile”, “Udhëheqës i Sektorit të Ndërtimit”, Komuna e Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me nenin 33 të paragrafit 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse pozita e lirë në shërbimin civil nuk mundet me qenë më gjatë se tre (3) muaj.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të vendimit me numër 05.09.2017 për caktimin e ushtuesit të detyrës për vendin e punës “Udhëheqës i Sektorit të Urbanizmit” në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, ka konstatuar se ushtuesi i detyrës ka qenë nga data 04.09.2017 deri më 03.12.2017, dhe me datë 05.12.2017 i vazhdohet vendimi për ushtuese të detyrës deri me datë 03.02.2018; pastaj Vendimi i datës 16.08.2017 për caktimin e ushtuesit të detyrës në vendin e punës “Udhëheqës i Sektorit Ligjor” nga data 17.08.2017 deri më 16.11.2017 pastaj vazhdohet vendimi për ushtues të detyrës nga data 17.11.2017 deri më 16.02.2018; Vendimi i datës 12.05.2017 për caktimin e ushtuesit të detyrës në vendin e punës “Udhëheqës i Sektorit të Ndërtimit” në kuadër të Drejtorisë së Inspekcionit, ushtuesi i detyrës është caktuar nga data 12.05.2017 deri më 11.08.2017 pastaj vazhdohet ushtuesi i detyrës nga data 25.08.2017 deri më 11.11.2017; Vendimi me numër 14.08.2017 për caktimin e ushtuesit të detyrës për vendin e punës “Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile” në kuadër të Drejtorisë së Administratës nga data 02.08.2017 deri më 01.11.2017 pastaj vazhdohet nga data 02.11.2017 deri më 01.02.2018; Vendimi i datës 16.03.2017 për caktimin e ushtuesit të detyrës për vendin e punës “Udhëheqës i Sektorit për menaxhim të mbeturinave” në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike nga data 20.03.2017 deri më 19.06.2017, pastaj vazhdon nga data 20.06.2017 deri më 19.09.2017 si dhe nga data 01.11.2017 deri më 31.01.2018; Vendimi i datës 01.03.2017 për caktimin e ushtuesit të detyrës për vendin e punës “Drejtoresh e Qendrës Kulturore të Fëmijëve” në kuadër të Drejtorisë së Kulturës ushtuesi i detyrës është caktuar nga data 01.03.2017 deri më 31.05.2017 pastaj vazhdohet me ushtues të detyrës nga data 07.07.2017 deri më 06.10.2017; Vendimi i datës 10.07.2017 për caktimin e ushtuesit të detyrës për vendin e punës “Drejtor i Arkivit Komunal” ushtuesi i detyrës është caktuar nga data 07.07.2017 deri më 06.10.2017 pastaj vazhdohet me ushtues të detyrës nga data 15.11.2017 deri më 31.12.2017; Vendimi i datës 06.09.2017 për caktimin e ushtuesit të detyrës për vendin e punës “Udhëheqës e Sektorit për Kadastër” në kuadër të Drejtorisë së Kadasrit nga data 01.09.2017 deri më 30.11.2017 pastaj vazhdohet me ushtues të detyrës nga data 01.12.2017 deri më 28.02.2018; Vendimi i datës 04.05.2017 për caktimin e ushtuesit të detyrës për vendin e punës “Udhëheqës i Sektorit të Rendit Komunal” në kuadër të Drejtorisë së Inspekcionit nga data 02.05.2017 deri më 01.08.2017, vazhdohet me ushtues të detyrës nga data 02.11.2017 deri më 01.02.2017 dhe vazhdohet me ushtues të detyrës nga data 02.08.2017 deri më 01.11.2017, Kolegji ka

konstatuar se me vendimet e lartë cekura për caktimin e ushtruesit të detyrës, Komuna e Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prishtinës, që të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për eliminimin e shkeljes që në rast të vendeve të lira të punës mos të mbetën më gjatë se tre (3) muaj ashtu siç është përcaktuar me nenin 30 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

II. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, nuk ka përgatitur planin vjetor të rekrutimit, ky institucion gjatë vitit 2017 ka pas dy (2) shpallje të konkursit dhe tri (3) rishpallje dhe nuk ka pas procedura të avancimit. Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, si mostra të procedurës së rekrutimit ka marrë dhe ka shqyrtuar procesin e rekrutimit “Inspektor i Shërbimeve Publike tre (3) ekzekutues” dhe “Zyrtar i Lartë Ligjor”.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të procesit të rekrutimit për vendin e punës “Inspektor i Shërbimeve Publike – tre (3) ekzekutues”, ka konstatuar se sipas konkursit të datës 13.01.2017 kushtet dhe kriteret e konkursit kanë qenë: *Diplomë Universitare, Minimum 3 vite përvojë pune etj.* Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të dosjes së kandidatëve të pranuar ka konstatuar se një nga kandidatë i pranuar nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit për sa i përket përvojës së punës, kandidati Shefki Beqiri, i cili posedon diplomën me numër 641 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, me të cilën dëshmohet se me datë 09.11.2015 ka përfunduar studimet dhe mori titullin Bachelor i Inxhinierisë Mekanike dhe nuk e plotëson kushtin e konkursit për tri vite përvojë pune.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prishtinës, që të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për anulimin e procedurës së rekrutimit për vendin e punës “Inspektor i Shërbimeve Publike – tre (3) ekzekutues” sepse emërimi i nëpunësve civil duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 18 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe të dispozitave të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Marrëveshjet për shërbime të veçanta: Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, gjatë vitit 2017 ka pas pesëdhjetë e shtatë (57) të angazhuar nëpunës me shërbime të veçanta, për pesëdhjetë e gjashtë (56) marrëveshje të shërbimeve të veçanta nuk janë zhvilluar procedurat e shkurtuara të rekrutimit ndërsa për vendin e punës me marrëveshje për shërbime të veçanta “Koordinator për punë me QKMF dhe QMU” janë zhvilluar procedurat e shkurtuara të rekrutimit.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të marrëveshjeve për shërbime të veçanta për vendin e punës: “Zyrtar i Lartë për media (fotograf) në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, Kolegji ka konstatuar se për këtë pozitë nuk janë zhvilluar procedurat e rekrutimit andaj Komuna e Prishtinës ka vepruar në

kundërshtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMI 3:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prishtinës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes, që të zhvillohen procedurat e thjeshtësuara të rekrutimit ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

E GJETURA 2: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të marrëveshjeve për shërbime të veçanta ka konstatuar, se marrëveshjet për shërbime të veçanta për vendin e punës: “Bashkëpunëtorë” në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publikë, për vendin e punës “Bashkëpunëtorë për legalizim” në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit; për vendin e punës “Bashkëpunëtorë për regjim Urban”; për vendin e punës “Bashkëpunëtorë për planifikim”; për vendin e punës “Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Lokale”

Kolegji ka konstatuar që në bazë të nenit 12 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ekzistojnë dy kategori të të punësuarve: **„pozitat e nëpunësve civilë të karrierës dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës”.**

Në kuptim të kësaj dispozite, pozitat e nëpunësve civil të karrierës apo të jo karrierës, nuk mund të plotësohen me nëpunës me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta.

REKOMANDIMI 4:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prishtinës, që me rastin e lidhjes së Kontratave me marrëveshjeve për shërbime të veçanta duhet pasur parasysh që të njëjtat nuk mund të lidhen marrëveshje të tilla por duhet ndjekur procedurat e parapara me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

III. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor është i themeluar me Vendimin me numër 01-031-57303 të datës 10.03.2016 dhe është në pajtim me dispozitat e nenit 70 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Komisioni Disiplinor, i Komunës së Prishtinës, gjatë vitit 2017 ka pas dymbëdhjetë (12) raste për shqyrtim dhe ka shqiptuar 10 masa disiplinore në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.04/2011 për procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe për dy raste tjera Komisioni Disiplinor ka konstatuar se nëpunësit civil nuk kanë kryer shkeljen e supozuar.

REKOMANDIMI 5:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prishtinës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme që Komisioni Disiplinor në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbim Civil, ti shqyrtoj rastet e paraqitura në Komision dhe varësisht nga shkelja të shqiptoj edhe masat disiplinore.

IV. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Prishtinës, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është i themeluar me Vendimin me numër 01-031-19503 të datës 26.01.2016 dhe është në pajtim me dispozitat e nenit 82 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar, se gjatë vitit 2017 Komuna e Prishtinës, ka pas 419 raste për shqyrtim në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave nuk ka vendosur për 244 raste e që është në kundërshtim me nenin 9 paragrafin 7 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjen së Kontesteve dhe të Ankesave.

REKOMANDIMI 6:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prishtinës, që të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për eliminimin e shkeljes dhe ankesat të cilat paraqiten nga nëpunësit civilë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave duhet të shqyrtohen nga ky komision dhe të merret vendim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh në pajtim me nenin 9 paragrafin 7 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjen së Kontesteve dhe të Ankesave.

V. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Prishtinës, nuk është bërë vlerësimi i rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil gjithsej janë mbete pa vlerësim të rezultateve të punës për vitin 2017, treqind e gjashtëdhjetë e dy (362) nëpunës civil dhe në këtë institucion për vitin 2017 është bërë vlerësim i periudhës provuese për njëmbëdhjetë (11) nëpunësit civil brenda afatit të përcaktuar ligjor.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se nga dosjet personale të nëpunësve civil, treqind gjashtëdhjetë e dy (362) nëpunës civil të Komunës së Prishtinës, nuk i`u është bërë vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2017.

Me këto veprime Komuna e Prishtinës, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me dispozitat nenit 3 të Rregullores Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 7:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prishtinës dhe Udhëheqësit e drejt për drejt të Komunës së Prishtinës, që të ndërmarr veprimet ligjore për eliminimin e shkeljeve dhe që për të gjithë nëpunësit civil të bëhet vlerësimi i punës nga udhëheqësit e drejtpërdrejtë të tyre ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me dispozitat e nenit 3 paragrafit 1.4 dhe 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

VI. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në formë fizike, ndërsa 258 nëpunës civil kanë shfrytëzuar pushimin mjekësor, 3 nëpunës pushim pa pagesë dhe 10 nëpunës pushimin e lehonisë. Të gjitha pushimet janë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

VII. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2017 ka pasur dhjetë (10) transferime, prej të cilave tre (3) transferime të përhershme, dy (2) transferime të përkohshme, katër (4) transferime të brendshme dhe një (1) të jashtme, të cilat transferime janë bërë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

VIII. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, ka 531 shqiptar, 3 boshnjak, 3 turk, 1 ashkali dhe 2 serb, prej 540 nëpunësve civil 237 janë të punësuar femra ndërsa 297 janë meshkuj ndërsa në këtë institucion ka dy (2) nëpunës civil i punësuar nga personat me aftësi të kufizuara.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 540 nëpunësve civil të punësuar në Komunën e Prishtinës, 237 prej tyre janë të punësuar femra ndërsa 297 janë të punësuar meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

REKOMANDIMI 8:

Rekomandojmë Kryetaren e Komunës së Prishtinës, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 540 nëpunësve civil të punësuar në Komunën e Prishtinës, nuk ka asnjë nëpunës me nevoja të veçanta, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas të cilës dispozitë është përcaktuar që „Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor”.

REKOMANDIMI 9:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prishtinës, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

IX. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Prishtinës, në këtë institucion nuk ka nëpunës civilë të pezulluar, një (1) nëpunës civil me pezullim të dakorduar, tre (3) pushime pa pagesë dhe një (1) marrje e detyrës së funksionarit publik, gjashtë (6) nëpunës civilë kanë ndërprerje të marrëdhënies së punës për shkak të dorëheqjes, pesëmbëdhjetë (15) nëpunës civilë iu ka ndërpre marrëdhëniet e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe dy (2) vdekje të nëpunësve civilë. Kolegji ka konstatuar se ndërprerja e marrëdhënies së punës për nëpunësit civilë është bërë në pajtim me dispozitat e ligjore të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores Nr.01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

X. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Prishtinës, ka një (1) nëpunës civilë i cili është emëruar/zgjedhur në funksione publike dhe i cili ka pezulluar vendin e punës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XI. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Prishtinës, për vitin 2017 nuk ka nëpunës ndaj të cilëve është filluar procedura penale.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XII. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Prishtinës, nuk ka përgatit planin individual të trajnimeve për secilin nëpunës sipas Formularit 3, nuk është përgatit plani për trajnim si dhe personali nuk ka të dhëna se sa nëpunës kanë ndjekur trajnimet po ashtu Zyra e Personelit nuk i ka evidencat e trajnimeve të nëpunësve civil.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Prishtinës nëpunësit civil nuk kanë përgatit Planin Individual të Trajnimeve siç përcaktohet me Manualin e Metodologjisë së Vlerësimit të Nevojave për Trajnim në

SHCK (Formulari 3) pasi që trajnimet janë pjesë e përgatitjes sa më të mirë të nëpunësve civil lidhur me përgjegjësit dhe detyrat e tyre.

REKOMANDIMI 10:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës dhe Udhëheqësin e Personelit të Komunës së Prishtinës, që të ndërmarr të gjitha veprimet pasi që për çdo nëpunës civil duhet të jetë i përgatitur plani individual i trajnimeve siç përcaktohet me Manualin e Metodologjisë së Vlerësimit të Nevojave për Trajnimin në SHCK dhe po ashtu duhet pasur informata të sakta lidhur me trajnimet e nëpunësve civil.

XIII. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, vijimin në punë e mban në formë elektronike. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet, ndërsa shtesat apo kompensimet tjera realizojnë zyrtarët e Teknologjisë Informative, puna jashtë orarit të punës, rastet e vdekjes së anëtarve të ngushtë të familjes të nëpunësve civil si dhe nëse nëpunësit civilë të cilët vdesin anëtarët e ngushtë të familjes kompensohen.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XIV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, i ka pranuar njëqind e njëzet e tre (123) vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ndaj vendimeve të Këshillit ka ngritur 48 padi në Gjykatën kompetente.

XV. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe monitorimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar dhjetë (10) të gjetura dhe ka dhënë dhjetë (10) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Komunës së Prishtinës, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Lela Petković

Kryetare e Kolegjit



Valentina Kaçandolli Bekteshi

Bashkëpunëtore Profesionale